

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS

KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORE DISIPLINORE E FKK-së

Prishtinë 2021

Rregullore disiplinore e FKK-së

DISPOZITAT TË PËRGJITHSHME

Fusha e Zbatimit dhe Qëllimi

Neni 1

1. Federata e Karatesë e Kosovës përpilon këtë Rregullore për të gjithë anëtarët e licensuar në të, Klubet, zyrtarët dhe trupat përbërëse të tyre si dhe të gjithë personat e tjerë që përfshihen në strukturat dhe veprimtaritë zyrtare të FKK-së, duhet ti njohin dhe ti zbatojnë të gjitha rregullat dhe vendimet e parashikuara në këtë Rregullore dhe në Rregulloret e tjera të miratuara nga FKK.

2. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është mbrojtja dhe funksionimi sa më i mirë i Federatës së Karatesë së Kosovës, detyrimet e klubeve dhe individëve ndaj FKK-së dhe anasjelltas, detyrimet e sportistëve, trajnerëve sportivë, gjyqtarëve dhe marrëdhëniet në mes tyre dhe FKK-së.

Neni 2

Rregullorja Disiplinore e FKK-së përcakton procedurën dhe masat disiplinore ndaj të gjithë atyre që çënojnë dhe shkelin rregullat në sportin e karatesë, që shkelin Statutin dhe Rregulloret e tjera përkatëse të FKK-së, si dhe atyre që çënojnë prestigjin e sportit të karatesë në mënyra të ndryshme, duke nënkuptuar edhe prezantimin e tij brenda dhe jashtë vendit.

KRITERET PËR PËRZGJEDHJE TË KRYESUESIT TË KOMISIONIT

Neni 3

1. Kryesuesi i komisionit do të përzgjedhet me konkurs të shpallur nga FKK-ja. Komisioni do të ketë **tre/pesë** anëtarë. Pas përzgjedhjes së kryesuesit, ai/ajo do të emrojë edhe **dy (katër)** anëtarë tjerë të cilët do të miratohen nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së.
2. Kriteret e përzgjedhjes të kryesuesit të Komisionit Disiplinor:
 - a. Një CV,
 - b. Njohja e rregullave të garave të karatesë,
 - c. Përvojë 5 vjeçare në gara të karatesë,
 - d. Diplomë Juristi/Administatë Publike,
 - e. Të mos ketë masa disiplinore pranë FKK-s në 5 vitet e fundit,
 - f. Aplikacioni i FKK-së i plotësuar.
3. Bordi Ekzekutiv i FKK-së mund të shkarkojë kryesuesin për mospërbushje të detyrave të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje.

QËLLIMI I MASAVE DISIPLINORE

Neni 4

Qëllimi i masave disiplinore është edukimi i anëtarëve të Federatës së Karatesë së Kosovës (sportistëve, trajnerëve, zyrtarëve dhe personave të tjerë që përfshihen në strukturat dhe veprimtaritë zyrtare të FKK-së), në frymën sportive, në forcimin dhe zhvillimin e përgjegjësisë dhe disiplinës së tyre, në zbatimin e drejtë të rregullave të përcaktuara, si dhe në ndikimin për sjellje sportive të simpatizuesve të tyre.

PËRGJEGJËSIA E KLUBEVE

Neni 5

Klubet Sportive janë përgjegjëse për mënyrën e sjelljeve dhe veprimeve të të gjithë të anëtarëve të tyre, brenda dhe jashtë ambienteve sportive gjatë kohës zyrtare të aktiviteteve sportive, si brenda dhe jashtë vendit.

NJOHJA DHE ZBATIMI I DISPOZITAVE

Neni 6

Sipas Statutit të FKK-së, çdo anëtar ka për detyrim të njohë, pranojë dhe t'i nënshtrohet Statutit dhe Rregulloreve të FKK-së dhe organizmave ndërkombëtare ku FKK është anëtarë, si WKF (Federata Botërore e Karatesë) dhe EKF (Federata Evropiane e Karatesë). Mosrespektimi dhe shkelja e dispozitave në të cilat është përcaktuar përgjegjësia disiplinore nuk e përjashton asnjërin nga anëtarët e FKK-së nga detyrimet e tij.

SHKELJET DISIPLINORE

Përkufizimi

Neni 7

Shkelje disiplinore do të quhen të gjitha veprimet dhe mosveprimet që dëmtojnë dhe shkelin Rregulloret dhe Statutin e FKK-së. Shkeljet disiplinore mund të jenë edhe në tentativë. Për shkeljet disiplinore në tentativë nga ai që nuk ka shkaktuar pasoja të dëmshme, mund të shqiptohet masë disiplinore më e lehtë se sa për shkeljet e kryera.

BASHKËPUNIMI DHE NXITJA

Neni 8

Në qoftë se shkelja disiplinore është shkaktuar me veprimin e më shumë pjesëmarrësve, të gjithë ata do të sanksionohen si bashkëpunues (bashkëpjesëmarrës). Kush e nxit tjetrin apo e ndihmon të shkaktojë shkeljen disiplinore, do t'i përcaktohet masa disiplinore përkatëse sikurse t'a kishte kryer vetë shkeljen.

KRYERJA E SHUMË KUNDRAVAJTJEVE

Neni 9

Në qoftë se janë kryer më shumë se një shkelje disiplinore, atëherë do të përcaktohet masa përkatëse disiplinore për secilën shkelje veç e veç.

EFEKTI I MASAVE DISIPLINORE

Neni 10

Dënimi i plotfuqishëm apo masa e ndërmarrë, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, duhet të ketë efekt veprues në veprimtarinë e anëtarëve dhe të klubeve të karatesë. Personi apo klubi i dënuar apo i pezulluar në ushtrimin e të gjitha funksioneve në FKK, nuk mund t'a përfaqësojë klubin apo shtetin në gara shtetërore dhe ndërkombëtare gjatë kohëzgjatjes së dënimit.

KRITERET E NDËSHKIMIT

Neni 11

1. Në rastin e marrjes së vendimit për shqiptim të masave disiplinore për persona që kanë bërë/kryer shkelje disiplinore, do të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në masën e dënimit, e posaçërisht:

- a) pesha e shkeljes disiplinore dhe pasojat e saj;
- b) shkalla e përgjegjësisë së kryerësit të shkeljes disiplinore;
- c) vetitë morale të personit që ka kryer shkeljen;
- d) sjelljet e mëparshme të personit, përkatësisht a është dënuar dhe më parë për shkelje të njëjta apo të ngjashme të rregullave disiplinore në sportin e karatesë (recidivizmi); dhe
- e) sjelljet dhe qëndrimi i të dënuarit para dhe pas dhënies së dënimit të mëparshëm nëse ka pasur një të tillë.

2. Varesishtë nga rrethanat e provuara bëhet edhe shqiptimi i dënimit.

PËRSËRITJA E SHKELJES DISIPLINORE

Neni 12

Shkeljet disiplinore të kryera në përsëritje, do të ndërshkohen më ashpër (recidivistat).

E DREJTA E DËGJIMIT

Neni 13

Askush nuk mund të dënohet pa ju dhënë mundësia për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore me komisionin e disiplinës. Gjithashtu, komisioni disiplinor bazuar në situatën e shkaktuar mund të ftoj edhe inicuesin e çështjes për dëgjim. Nëse autori i kundërvajtjes disiplinore nuk paraqitet pas dy ftesave të organit kompetent, vendimi për dënim mund të bëhet në bazë të argumenteve të mbledhura edhe pa praninë e kundërvajtësit.

RASTET ME PRIORITET

Neni 14

Procedura disiplinore me prioritet që duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur konsiderohen rastet për:

1. anëtarët e bordit ekzekutiv;
2. zyrtarët administrativ të FKK-së;
3. kryesuesit dhe anëtarët e komisioneve të FKK-së;
4. selektorët dhe trajnerët e përfaqësueses;
5. anëtarët e ekipit të përfaqësueses;
6. gjyqëtarët e FKK-së

PARASHKRIMI

Neni 15

Parashkrimi i një rasti të ndëshkueshme me këtë rregullore arrihet me përfundim të mandatit të Bordit Ekzekutiv.

EVIDENTIMI I VENDIMEVE

Neni 16

Vendimet e plotfuqishme për dënimet e shqiptuara, evidentohen në librat amë përkatës të FKK-së. Vendimet e plotfuqishme për dënimin e klubeve të karatesë, shpallen publikisht dhe arkivohen në FKK.

LLOJET E MASAVE DISIPLINORE

Neni 17

1. Për kundërvajtje disiplinore mund të shqiptohen këto masa disiplinore:
 - a) Vërejtje me gojë;
 - b) Qortim me shkrim;
 - c) Dënim me para;
 - d) Ndalimin e pjesëmarrjes për një kohë të caktuar në aktivitete shtetërore dhe ndërkombëtare;
 - e) Dënim me heqjen e titullit të fituar në aktivitetet shtetërore;
 - f) Ndalim i ushtrimit të funksioneve në organet e FKK-së;
 - g) Pezulim nga Federata e Karatesë e Kosovës;
 - h) Përrjashtim nga Federata e Karatesë e Kosovës.
2. Komisioni disiplinor mund të shqiptojë masën e pezullimit për pjesëmarrje në aktivitete shtetërore dhe ndërkombëtare deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

DËNIMI ME PARA

Neni 18

1. Dënimi financiar në të holla mund t'ju jepet personave që ushtrojnë detyra profesionale në karate dhe në Federatën e Karatesë së Kosovës, dënimi me para nuk mund të jetë më i vogël se 50.00 € e as më i madhë se 1000.00 € për individë, ndërsa për klube nga 450.00 € deri në 3000.00 € të cilat duhet të shlyhen në periudhën kohore prej 3 muajsh për individë dhe jo më shumë se 15 deri në 30 ditë për Klube Sportive pas publikimit të Vendimit.
2. Në vendimin mbi dënimin përcaktohet afati dhe mënyra e pagesës së dënimin në të holla, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dhënia përfundimtare e tij dhe as më i gjatë se 30 ditë për klubet e Karatesë, ndërsa për persona jo më shumë se 3 muaj. Dënimi financiar mund të jepet si dënim kryesor i parë dhe si dënim plotësues i dorës së dytë.

Neni 19

Shumat nga dënimet me të holla paguhen në llogarinë bankare të Federatës së Karatesë së Kosovës.

SHKELJET E RËNDA DISIPLINORE

Neni 20

1. Shkelje të rënda disiplinore sipas kësaj rregulloreje cilësohen rastet dhe veprimet nga cilido preson fizik dhe juridik me vetëdije të plotë:
 - a) Sulmi dhe lëndimi trupor;
 - b) Dëmi marterial;
 - c) Ngacmimi dhe abuzimi skekual;
 - d) Prishja e rendit në aktivitetet zyrtare të FKK-së;
 - e) Falsifikimi i dokumentacionit dhe qitja e FKK-së në lajthitje si pasojë e falsifikimit;
 - f) Shkelja dhe mosrespektimi i vendimeve të FKK-së
2. Veçanërisht si raste të shkeljeve të rënda disiplinore për të cilat organet disiplinore mund t'i japin shkelësit dënimin më të rëndë, konsiderohen ato shkelje, gjatë kryerjes së të cilave shkelësi ka vepruar me vetëdije të plotë, vendosmëri, këmbëngulje dhe pa arsye të veçantë, apo kur shkelja e rëndë disiplinore ka shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, apo është kryer në rrethana veçanërisht të rënda.

SHKELJET DISIPLINORE TË ANËTARËVE

Neni 21

Për të gjitha shkeljet disiplinore të shkaktuara nga anëtarët e klubeve, mund të denohën/ndëshkohën dhe nga vetë klubet e karatesë. Ndëshkimi/denimi nga klubi i anëtarit të tij nuk përjashton dënimin nga FKK.

SHKELJET DISIPLINORE TË KLUBEVE

Neni 22

Shkelje disiplinore të klubeve konsiderohen, por nuk kufizohen, vetëm në:

1. Bojkot të garave;
2. Mospërbushja e detyrimeve ndaj FKK-së
3. Falisifikimi i të dhënave;
4. Mospërbushja e detyrimeve financiare ndaj FKK-së;
5. Pjesëmarrja pa miratim në garat ndërkombëtare;
6. Organizmi pa miratim i garave të karatesë;
7. Dëmtimi i reputacionit të vendit;
8. Ushtrimi i veprimtarisë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
9. Manipulimi i ndeshjeve.

BOJKOTI I GARAVE

Neni 23

Klubi i cili nxitë dhe/ose organizon bojkot të garave dhe pengim të zhvillimit të aktiviteteve zyrtare të FKK-së. Në raste të tilla klubi do të ndëshkohet me pezullim prej 3 muaj deri në 6 muaj, ndërsa përsëritja e veprimve të tilla do të tërheq dënim me përjashtim prej 1 deri në 3 vite dhe me gjobë në shumë prej 1000.00 deri në 4000.00 €.

MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDAJ FKK-së**Neni 24**

Klubi ose Trajneri i cili nuk i përmbush detyrimet e tij dhe pengon anëtarët për të marrë pjesë në aktivitetet kombëtare ose ndërkombëtare me ekipin e përfaqësuesës së Kosovës, do të dënohet me përjashtimin e tij nga 1 muaj deri në 3 muaj, ndërsa përsëritja e veprimeve tërheq dënime me përjashtim 6 muja deri në 1 vit dhe dënim me gjobë në shumën prej 100 deri në 300.00 €.

FALSIFIKIMI I TË DHËNAVE**Neni 25**

Klubi dhe/ose anëtari i klubit, i cili jep të dhëna të pavërteta dhe ofron dokumente të falsifikuara me qëllim dhe vetëdije të plotë FKK-së, do të ndëshkohet me dënim me gjobë në shumën prej 500.00 deri 2500.00€, si dhe shqiptim të njërës nga masat disiplinore sipas nenit 16, pikat (g), (h), dhe (i) të kësaj rregulloreje.

MOSPËRMBUSHJA E DETYRIMEVE FINANCIARE**Neni 26**

Klubi apo përfaqësuesi i klubi, i cili nuk i përmbush detyrimet financiare ndaj FKK-së, mosshlyerja e gjobave të shqituara nga komisionet përkatëse, ka për pasojë pezullimin e statusit të anëtarit, ndërsa në rastet më të rënda dhe të përsëritura mund të dënohet me përjashtim nga FKK prej 1 (një) deri në 2 (dy) vjet.

PJESËMARRJA PA MIRATIM NË GARAT NDËRKOMBËTARE**Neni 27**

Klubi, i cili merr pjesë në gara rajonale dhe ndërkombëtare jashtë vendit (Kosovës) pa aprovim paraprak të FKK-së, do të dënohet me pezullim pjesëmarrje në gara rajonale dhe ndërkombëtare në kohëzgjatje nga 6 (gjashtë) muaj deri 1 (një) vit, ndërsa nuk sanksionon klubin për pjesëmarrje në gara vendore.

ORGANIZIMI PA MIRATIM I GARAVE TË KARATESË**Neni 28**

Klubi i cili organizon gara shtetërore dhe ndërkombëtare brenda vendit dhe nuk merr leje paraprake nga FKK do të dënohet deri në 1 (një) vit përjashtim nga të gjitha garat shtetërore dhe ndërkombëtare dhe dënim me gjobë në shumën prej 1000.00 deri 3000.00 €.

DËMTIMI I REPUTACIONIT TË VENDIT**Neni 29**

Klubi, sportistët apo funksionarët e të cilit me qëndrime dhe sjelljet e tyre jashtë vendit, i shkaktojnë dëme autoritetit/reputacionit të vendit (Kosovës), autoritetit/reputacionit të Federatës së Karatesë së Kosovës, do të dënohen me pezullim të pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare jashtë vendit

në kohëzgjatje nga 3 (tre) muaj deri 1 (një) vit. Për rastet e shkeljeve të rënda klubi, sportistët apo funksionarët do të dënohen me përjashtim nga FKK.

USHTRIMI I VEPRIMTARISË NË KUNDËRSHIM ME LEGJISLACIONIN NE FUQI

Neni 30

Klubi dhe/ose anëatri i klubit i cili ushtron veprimtarinë e vet në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës apo ligjeve të vendit, dispozitat e Statutit të FKK-së, Rregulloreve, kryen shkelje duke përdorur simbolet, vulën dhe duke kryer testime kualifikimi të cilat anashkalojnë autoritetin e FKK-së dhe Komisioneve të saj, dënohet me përjashtim nga FKK.

MANIPULIMI I NDESHJEVE

Neni 31

Klubet të cilat në fshehtësi kanë arritur marrëveshje për manipulimin e rezultatit të ndeshjeve në dobi të njërit apo tjetrit klub, do të dënohen me heqjen e titullit dhe dënim me para në shumën prej 200.00 deri 800.00 €. Për rastet e rënda dhe të përsëritura, klubet do të dënohen me përjashtim 2 vjeçar nga garat dhe dënim me gjobë në shumën prej 1500.00 deri 3000.00 €. Ndërsa personat përgjegjës të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, do të dënohen me pezullimin e të ushtruarit të gjitha funksioneve në sportin e karatesë, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajësh deri në 2 (dy) vjet. Tentimi i manipulimit të rezultatit të ndeshjeve do të ndëshkohet nga 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit.

KUNDËRVAJTJET E INDIVIDËVE

Sjelljet e Papranueshme

Neni 32

Sjellje të papranueshme konsiderohen të gjitha ato sjellje të cilat bien ndesh me Rregulloren e Garave të WKF-it. Garuesi i cili përjashtohet nga gara me SHIKAKU do t'i shqiptohet masa disiplinore sipas nenit 32, me ndalim të pjesëmarrjes në gara në periudhë kohore prej 6 (gjashtë) muajsh deri në përjashtim të përhershëm.

PENGIMI DHE PRISHJA E RENDIT TË GARËS

Neni 33

Sportisti, trajneri apo personi përgjegjës në klubin sportiv, i cili organizon, nxitë pjesëmarrësit e tjerë të pengojnë zhvillimin normal të ndeshjeve sportive, dënohet me ndalim të ushtrimit të të gjitha funksioneve në kohëzgjatje prej 3 muaj deri në një 1 (një) vit dhe dënim me para në shumë prej 200.00 deri në 1000.00 €.

TËRHEQJA E KLUBIT NGA GARA**Neni 34**

Kur trajneri përgjegjës vendos të tërheqë klubin e tij nga gara në mënyrë demonstrative për ndonjë arsye të tij/saj, duhet të njoftojë me shkrim për veprimin e ndërmarr Komisionin e garave. Për këtë rast Komisioni Disiplinor i Federatës, pasi e shqyrton rastin do të ndërmerr masa adekuate sipas rregulloreve të FKK-së.

SJELLJET E NDALUARA TË SPORTISTËVE**Neni 35**

1. Komisioni Disiplinor do të ndërmerr masa adekuate për secilin garues i cili bënë sjllje në kundërshtim me Rregulloren e Garave të WKF-së dhe do të ndëshkohet sipas rregullave të parapra me Rregullore të Garave të WKF-të
2. Sportisti i cili tenton, ose fizikisht sulmon sportistin kundërshtar, gjyqtarët, personat zyrtarë apo spektatorët gjatë zhvillimit të garës së karatesë ose pas përfundimit të saj, në sallë apo në kompleksin ku ndodhet salla, do të dënohet me përjashtim nga garat në kohëzgjatje prej 1 (një) viti deri në 3 (tri) vite nga FKK. Në raste të shkeljeve të rënda edhe me përjashtim të përjetshëm nga sporti i karatesë dhe gjobë në lartësi prej 1000.00 deri 4000.00 €.
3. Dispozitat e paragrafëve parapra do të aplikohen edhe për të gjithë personat zyrtarë të garave të cilët tentojnë ose shkaktojnë shkelje disiplinore për të cilën do të dënohen me pezullim të ushtrimit të të gjitha funksioneve në sportin e karatesë së paku 2 (dy) vjet e në raste të rënda edhe me përjashtim nga FKK.

DOKUMENTACIONI I FALSIFIKUAR**Neni 36**

1. Sportisti i cili paraqet dokumente të falsifikuara me qëllim dhe vetëdije të plotë për regjistrim në gara apo aktivitete tjera, do të dënohet me përjashtim nga garat nga 1 (një) vit deri në 3 (tri) vjet.
2. Nëse kundërvajtjen e parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen trajneri i ekipit, do të dënohet me ndalim të ushtrimit të të gjitha funksioneve në karate nga 2 (dy) deri 4 (katër) vjet, ndërsa në rastet e rënda me përjashtim nga FKK.
3. Nëse garuesi nuk është në dijeni për veprimet e trajnerit lidhur me falsifikimin e dokumentacionit të tijë, nuk vlen paragrafi 36.1 i këtij neni.

REFUZIMI I PJESËMARRJES NË PËRFAQËSUESE**Neni 37**

1. Garuesi i cili pa arsye bindëse refuzon pjesëmarrjen në garat e përfaqësueses dhe/ose refuzon t'i bashkëngjitet përgatitjeve që organizohen nga FKK, do t'i shqiptohet masa disiplinore si në vazhdim:
 - a) Për refuzim pjesëmarrjeje në përgatitje ndëshkohet me mospjesëmarrje në garën vijuse ndërkombëtare;
 - b) Për refuzim në pjesëmarrje në garë, ndëshkohet me 6 (gjasthë) muaj deri në 1 (një) vit mospjesëmarrje në gara ndërkombëtare.

MOSDEKLARIMI I INFORMACIONIT**Neni 38**

Sportisti, trajneri, gjyqtari apo përgjegjësi i ekipit, të cilin organi disiplinor e fton në bisedë informuese ose prej të cilit kërkon deklaratë me shkrim, e i cili pa arsye nuk i përgjigjet ftesës apo nuk dëshiron të dërgojë deklaratën e kërkuar ose atë e dërgon pas afatit të përcaktuar, do t'i shqiptohet masë disiplinore vërejtje, qortim ose përjashtim, përkatësisht nga 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit.

SJELLJET JO-SPORTIVE**Neni 39**

1. Cilido që sillet në mënyrë jo sportive (ofendon, fyen, shanë, etj.), ndaj sportistëve, gjyqtarëve, trajnerëve, zyrtarëve, drejtuesve të komisioneve dhe klubeve të karatesë, para, gjatë dhe pas përfundimit të garës së karatesë do t'i shqiptohet masa disiplinore vërejtje, qortim ose përjashtim nga aktiviteti deri në 1 (një) vit.

2. Nëse sportistët apo personat e tjerë zyrtarë të klubeve, Federatës, gjyqtarët dhe persona të organeve të tjera të karatesë japin deklaratë për shtyp, në media dhe rrjete sociale opinion të pasaktë, të paargumentuara, të cilat dëmtojnë autoritetin e Federatës, do t'u shqiptohet masa disiplinore pezullim nga 1 (një) vit deri në 2 (dy) vjet.

SHKELJET E GJYQËTARËVE**Neni 40**

Masat disiplinore për gjyqëtarë për sjellje dhe veprime që bien ndesh me rregulloren e referimit do të shqiptohen sipas dispozitave të parapara në rregullore të referimit. Shkeljet tjera të gjyqëtarëve sikurse të cilitdo anëtarë të FKK-së do të trajtohen konform kësaj rregulloreje.

DËSHTIMI NË KRYERJE TË DETYRAVE**Neni 41**

Në qoftë se anëtar i FKK-së, kërkon prej anëtarëve të tjerë, klubeve, gjyqëtarëve, sportistëve, trajnerve etj, shpërblim material për kryerjen e punëve për të cilat është caktuar, ose ato nuk i kryen edhe pse është i obliguar dhe autorizuar t'i kryejë, do të dënohet me pezullim nga të gjitha funksionet deri në 1 (një) vit, me mundësi të rishikimit të masës, e në rastet e përsëritjes dhe dëmtimit të prestigjit dhe imazhit të karatesë dhe FKK-së, me përjashtim të përhereshëm. Nëse kundërvajtjen e ka shkaktuar zyrtari apo anëtar i klubit, atëherë klubi do të dënohet me para të gatshme në shumën 500.00 €.

MOSZBATIMI I VENDIMEVE**Neni 42**

Klubi i cili nuk e zbaton vendimin e plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm të Komisionit Disiplinor dhe vendimin e Bordit Ekzekutiv të FKK-së, do të ndëshkohet deri në përjashtim dhe me dënim me gjobë në shumën deri 2000.00 €.

PËRDORIMI I SUBSTANCAVE DOPING-STIMULUESE**Neni 43**

1. Përdorimi dhe shpërndarja e substancave dhe metodave doping të shënuara në listën e WADA-s dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar është e ndaluar për të gjithë pjesëmarrësit në veprimtaritë sportive të Karatesë në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj.

2. Çdo përdorim i substancave dhe metodave të dopingut, si dhe nxitja për përdorimin e tyre, dënohen konform rregullores së Federatës Botërore të Karatesë (WKF), pranuar nga Federata e Karatesë e Kosovës, me jo më pak se 2 (dy) vjet përjashtim nga çdo lloj veprimtarie sportive. Njëkohësisht sportisti është i detyruar të kthejë shpërblimet e fituara, në rastëse ka fituar Medalje në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare madhore (Kampionat Ballkanik, Kampionati Mediteran, Kampionat European, Kampionat Botëror, Lojërat Evropiane ose Olimpiadat).

3. Refuzimi nga ana e sportistëve për të bërë kontrollin Anti-Doping, do të konsiderohet i barabartë me një rezultat pozitiv të kontrollit Anti-Doping.

4. FKK do të zbatojë të gjitha parimet dhe dispozitat e parapara në Rregullore të Anti-Dopingut të FKK-së dhe për çfarëdo veprimi në kundërshtim me atë rregullore do të ndërmerren masa sipas Rregullores Anti-Doping të FKK-së dhe Rregullores Disiplinore.

KOMISIONI KOMBËTAR ANTIDOPING**Neni 44**

1. Federata e Karatesë e Kosovës, njeh autoritetin e Agjencisë së Kosovës për Anti-Doping në ushtrimin e kontrolleve antidoping në sportistët dhe anëtarët tjerë të FKK-së.

2. FKK, pranon masat disiplinore të dhëna nga Agjencisë së Kosovës për Anti-Doping dhe Federata Botërore e Karatesë (WKF) për sportistët anëtarë të FKK, që rezultojnë pozitiv në këto kontrolle.

APELIMI**Neni 45**

Në raste apelimi/ankese nga individi, ose Klubi Sportiv ndaj vendimit të dhënë për rezultat pozitiv në test anti-doping, ai që e kërkon apelim për një analizë të dytë, do të mbulojë të gjitha shpenzimet që rrjedhin për bërjen e kësaj analize.

DISPOZITAT PROCEDURALE**Organet Kompetente****Neni 46**

1. Organet kompetente për marrjen e vendimeve dhe shqiptimin e masave disiplinore janë:

- a) Kuvendi i Anëtarëve të FKK-së;
- b) Bordi Ekzekutiv i FKK-së;
- c) Komisioni i Disiplinor.

2. Kuvendi i Anëtarëve të FKK-së, është organi më i lartë i Federatës, i cili miraton masat e shqiptuara disiplinore të rënda, dhënë nga organet e saj për përjashtim dhe heqjen e të drejtës së anëtarit të FKK-së.

3. Bordi Ekzekutiv i FKK-së ka kompetencë të miratojë propozimet e Komisionit Disiplinor në lidhje me pezullimet e anëtarëve. Gjithashtu në rast anëkesë Bordi Ekzekutiv mund të anulojë një vendim disiplinor, kur ai nuk i është përmbajtur procedurave ligjore të Rregullores Disiplinore dhe rregulloreve përkatëse.

4. Komisioni i Disiplinor është organ i analizimit dhe gjykimit të sjelljeve të të gjithë anëtarëve të anëtarësuar në FKK-së, për zbatimin e Statutit, Rregullores Disiplinore, Kodit të Etikës dhe të gjitha Rregulloreve tjera të FKK-së gjatë veprimtarisë zyrtare të sezonit sportiv të Karatesë brenda dhe jashtë vendit. Vendimet e Komisionit Disiplinor duhet të regjistrohën/arkivohën pranë administratës së FKK-së dhe ato paraqiten në Bordin Ekzekutiv të Federatës në mbledhjen e radhës së këtij organi.

FILLIMI I PROCEDURËS DISIPLINORE

Neni 47

1. Procedura disiplinore fillohet në bazën e lajmërimit zyrtar nga FKK-ja drejtuar anëtarit që është subjekt i procedurës disiplinore. Të gjitha lajmërimet duhet të jenë të kompletuara dhe të argumentuara mirë, të firmosura dhe vulosura zyrtarisht nga FKK-ja.

2. Komisioni Disiplinor mund të fillojë hetim edhe nga anëkesat anonime apo edhe ex-officio (sipas detyres zyrtare) kurdo që ky organ ka informata të bazuara mbi shkeljet e mundëshme të kësaj Rregullorëje ose Rregulloreve tjera në fuqi nga ana e FKK-së.

PËRGJEGJËSIA E ORGANEVE DISIPLINORE

Neni 48

Organet disiplinore janë të detyruara të kujdesen për autorizimet e veta, përgjegjësitë, kompetencat, afatet, parashkrimet dhe njoftimet për masat disiplinore.

NJOFTIMI I KUNDRAVAJTËSIT

Neni 49

Personi që ka kryer shkelje duhet të vihet në dijeni nga Komisioni Disiplinor për shkeljen e shkaktuar brenda 7-ditëve nga koha kur organet disiplinore janë njoftuar për shkeljen. Kur Komisioni Disiplinor fillon procedurën, ai e fton të pandehurin për dhënien e deklaratës dhe për t'a marrë në pyetje brenda 10 (dhejtë) ditëve.

AFATET

Neni 50

1. Procedura disiplinore zhvillohet sipas afateve të caktuara. Në shkallën e parë duhet të përfundojë në afat prej 12 (dymbdhjetë) ditësh nga dita e fillimit. Procedura disiplinore në shkallë të dytë duhet të përfundojë në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e marrjes së ankesës.

2. Organi disiplinor i shkallës së parë (Komisioni Disiplinor) është i detyruar që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së ankesës, të kompletojë dokumentacionin e procedurës së shkallës së parë dhe atë t'ia përcjellë organit të shkallës së dytë (Bordi Ekzekutiv) për shqyrtim të mëtejshëm.

MOSRESPEKTIMI I AFATEVE

Neni 51

Në rastet kur nuk veprohet sipas afateve të parashikuara, kryetari dhe anëtarët e Komisionit Disiplinor do të përgjigjen për shkelje të procedurave të kësaj rregulloreje në Bordin Ekzekutiv të FKK-së.

PËRJASHTIMI

Vendimmarrja

Neni 52

1. Shkelja serioze e Statutit, Rregulloreve dhe Vendimeve të FKK-së i jep të drejtën Kuvendit të Anëtarëve të marrë vendime deri në përjashtimin e anëtarit nga FKK.
2. Në raste të veçanta, të rënda, Bordi Ekzekutiv pas rekomandimit të Komisionit Disiplinor mund të japë pezullim të përkohëshëm për përjashtim deri në Kuvendin e radhës, e cila shprehet me një vendim të Bordit Ekzekutiv. Çdo vendim pezullimi përbën humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit për sa kohë që vendimi mbetet në fuqi.

MBULIMI I SHPENZIMEVE

Neni 53

1. Nëse gjatë procedurës disiplinore janë shkaktuar shpenzime, atëherë organi, i cili ka drejtuar procedurën, do të vendosë për subjektet për përmbushje të tyre. Shpenzimet e shkaktuara nga ana e klubit apo anëtarit të klubit të cilit i shqiptohet masa disiplinore, do të mbulohet nga klubi.
2. Në qoftë se klubi apo anëtari i klubit, ndaj të cilit është hapur procedura, lirohet nga përgjegjësia, shpenzimet do të paguhen nga organi i cili e ka drejtuar procedurën.

SHQIPTIMI I MASAVE DISIPLINORE

Kuorumi

Neni 54

Vendimet për shqiptimin e masave përkatëse merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të organeve të disiplinës.

KOMUNIKIMI I VENDIMEVE**Neni 55**

1. Vendimet e organeve disiplinore, u komunikohen palëve personalisht me shkrim (postë elektronike ose me letra postare rekomande). Nga një kopje të vendimit mbi masat e shqiptuara për persona fizik, organi disiplinor është i detyruar t'ia dorëzojë njëkohësisht edhe klubit të karatesë, anëtar i të cilit është personi i ndëshkuar. Në qoftë se organi disiplinor nuk e ka adresën e saktë të personit fizik, dorëzimi i vendimit mund të bëhet përmes një anëtari të ekipit, anëtar i të cilit është personi. Në rast të refuzimit të marrjes të vendimit, konsiderohet se është bërë dorëzimi i vendimit.
2. Vendimet e organeve disiplinore për klube do të komunikohen personalisht me shkrim (postë elektronike ose me letra postare rekomande) në adresë të klubit/ve, përfaqësuesit të klubit, apo ndonjërit nga anëtarët e klubit në fjalë. Në rast të refuzimit të marrjes të vendimit, konsiderohet se është bërë dorëzimi i vendimit.

APELI DHE KUNDERSHTIMI I VENDIMIT**Apelimi i Vendimit****Neni 56**

1. Kundër vendimit të Komisionit të Disiplinor mund të apelohe me shkrim pran Bordit Ekzekutiv, brenda 10 diteve nga marrja e vendimit të Komisionit Disiplinor.
2. Bordi Ekzekutiv, brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës mund:
 - a) t'a refuzojë atë për shkak të afatit, ose në rastet kur nuk është bërë nga personi i autorizuar;
 - b) t'a refuzojë dhe të lërë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor;
 - c) t'a aprovojë dhe t'ia kthejë Komisionit Disiplinor në rishqyrtim të çështjes; dhe
 - d) t'a aprovojë, ndërsa vendimin e Komisionit Disiplinor t'a ndryshojë, qoftë dhe duke renduar ose lehtësuar masën disiplinore.
3. Vendimi i Bordit Ekzekutiv është përfundimtar.

KUNDËRSHTIMI I VENDIMIT**Neni 57**

1. Vendimet e përfundimtare të organit disiplinor të Federatës mund të kundërshtohen nga palët në Komisionin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK).
2. Vendimet e KAS pranohen nga organet drejtuese dhe anëtarët e FKK-së.

LEHTËSIMI I JASHTËZAKONSHËM I DËNIMIT**Neni 58**

Kur ekzistojnë prova të pakontestueshme se masa e shqiptuar, e cila është ekzekutuar, e ka arritur qëllimin e vet në të gjitha aspektet edukativo-sportive, Bordi Ekzekutiv i FKK-së në raste të caktuara mund të lehtësojë masat. Po ashtu, lehtësimin e masave mund t'a bëjë edhe Kuvendi i Anëtarëve të FKK-së nëse më parë Bordi Ekzekutiv i FKK-së ka refuzuar kërkesën për lehtësim të

FKK 2021

të ndëshkuarit. Lutjen si në rastin e parë edhe në rastin e dytë për uljen e jashtëzakonshme të dënimit, mund t'a dorëzojë personi i dënuar apo klubi, anëtar i të cilit është i dënuari, në një afat prej 10 (dhjetë) ditësh para mbledhjes së caktuar të Kuvendit të Anëtarëve të FKK-së.

INTERPRETIMI

Neni 59

Bordi Ekzekutiv i FKK-së është i autorizuar të japë interpretime autentike të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

AMANDAMENTIMI

Neni 60

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje do të bëhen në mënyrën dhe procedurën të njëjtë si miratimi i saj.

HYRJA NË FUQI

Neni 61

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së dhe nënshkrimit nga kryetari i FKK-së.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi

Kryetar

